



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	04.02.2025
Referencë	11-344/1
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-janar

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit janar Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- Kanë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste. Pjesë e agjendës së inspektorëve të tregut ka qenë inspektimi i marketeve. Është kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e mallit.

Janë inspektuar Rentat në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” ku nuk kemi hasur në ndonjë rast duke ushtruar veprimtari ilegale.

Gjatë këtij muaji është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve, nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë kontrolluar deponit ilegale të mbeturinave në fshatrat Gadime e Ulet, në Kodrën e Kërçevës, Sllovi, afër fabrikës së letrës, për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjinden dëshmi për ndotje të mjedisit. Në Gadime të Ulët dhe kodrën e Kërçevës janë gjetur dëshmi për mbeturinat e hedhura, por edhe janë takuar persona duke i dërguar mbeturinat për t’i hedhur në kodrën e Kërçevës. Personave apo bizneseve për parregullsitë e gjetura i janë dhënë urdhëresë për largimin e mbeturinave nga vendi të cilët i kanë hedhur dhe dorëzimi tek K. Pastrimi, e gjithë kjo është kërkuar të bëhet me dëshmi (foto). Pas rikontrollave tek vendi i ngjarjes, por edhe në bazë të dëshmive të paraqitura nga pala, u konstatua se urdhëresat janë zbatuar.

Gjithashtu sipas ankesave të pranuar nga një qytetarë, se një kafshë e ngordhur është hedhur në pyll mbi fshatin Gadime e Epërme, është dalë në vende ngjarje dhe në bazë të matrikullimit është gjetur pronari i cili e ka hedhur lopën e ngordhur. Personit i është dhënë urdhëresë për groposjen e lopës së ngordhur, sepse komuna nuk ka ndonjë kontratë për trajtim për raste të tilla. Urdhëresa është zbatuar nga personi, kafsha e ngordhur është groposur.

Inspektorët e trafikut- Gjatë muajit janar kemi bërë inspektimin në Aeroportin “Adem Jashari” ku është bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksit ilegal, po ashtu janë inspektuar disa kompani të radio-taksit të cilët kishin licenc dhe merrnin udhëtar vetëm me porosi.

Inspektori i ndërtimit- Gjatë muajit janar ka pasur inspektime të rregullta në terren dhe janë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi, janë realizuar inspektime edhe sipas kërkesës së investitorëve. Është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal.

Në një objekt ndërtimorë janë vendosur shiritat zyrtar e ndaluar punimet

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit janar janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspekte për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	109	11	6						52	15				75.00€	6	12	5			2
Ambienti	15	6							2	3								3	1	
Ndërtimi	17	2				7	1		3	4										
Trafiku	53	13						18	6			2				12			2	
Gjithsej	194	32	6			7	1	18	63	22		2		75.00€	6	24	5	3	3	2

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.

